



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga Rezarta Schuetz kryesuese, Natasha Mulaj relatore, Albana Shtylla, Ina Rama, Sokol Çomo anëtarë, shpalli vendimin për çështjen nr. 50/2024, datë 11.12.2024, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Aulona Bodo kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 801, datë 19.09.2024.

Në përfundim të gjykimit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 801, datë 19.09.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Aulona Bodo.

Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 02.02.2026, në Tiranë.

POSTUAR NGA: NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME/](https://kpa.al/category/njoftime/))

< Njoftim (<https://kpa.al/njoftim-1672/>) Njoftim (<https://kpa.al/njoftim-1673/>) >